



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.07

Prishtinë, më 11.03.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyqi.

Munguan: Salih Morina, Mufera Sinik, Jelena Bontiç.

Pjesëmarrës të tjerë: Florina Merovci – zyra e Presidentes, Isuf Koci – KKTK, Petrit Hysaj-OSBE-së, Lirije Palushi dhe Lirika Demiri- organizata CPC, Blendina Krasniqi-UNDP(praktikante).

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.02.2015;
3. Shqyrtimi i listës së kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.02.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 27.02.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i listës së kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor

Kryetari i Komisionit, Nait Hasani, tha se Komisioni ka shqyrtuar listën e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor të cilën e ka sjell Ministri me emrat e 14 të propozuarëve dhe konstaton që kjo listë nuk është e plotë, lista ka paqartësi dhe hasim në konflikte interesi, në këtë listë ka gabime dhe propozon që në emër të Komisionit ti kërkojnë Ministrin me shkresë që ta plotësojë dhe ta verifikojë këtë listë, duke ia bashkangjitur edhe CV-të.

Shpejtim Bulliqi, tha se kjo listë përmban gabime si në emrat e kandidatëve të propozuar po ashtu edhe në profesionet e tyre, siç është rasti me propozimin që është në listë me numër rendor 13.

Teuta Haxhiu, tha se pajtohet me atë se për secilin kandidat që është pjesë e kësaj liste ta kenë CV-në me të gjitha dokumentet përkatëse, në mënyrë që si Komision të mos bëjmë gabime.

Ismajl Kurteshi, tha se Komisioni duhet ta njoftoi Ministrinë për arsyet se pse nuk e ka shqyrtuar propozimin e tij dhe të bëjë kërkesë që emrat e atyre të cilët kanë aplikuar bashkë me CV ti sjellin, në mënyrë që Komisioni të merret me këtë çështje.

Bekim Haxhiu, tha se përveç CV-së ti sjellin edhe kopjet e diplomës dhe dokumentacionit tjetër përkatës.

Pas debatit, Komisioni, erdhi në përfundim se:

- 1. Propozimi i anëtarëve për Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturor nuk respekton përbërjen etnike në Kosovë (Neni 4 paragrafi 4.8 i Ligjit për Trashëgimi Kulturor),*
- 2. Disa nga emrat e propozuar përbëjnë konflikt interesi,*
- 3. Lista ka gabime në emra dhe profesione të kandidatëve të propozuar,*
- 4. Listës i mungojnë CV-të e të gjithë kandidatëve të propozuar,*
- 5. Lista nuk mund të përmbajë më pak se 14 propozime, ndërsa mund të ketë më shumë se 14 propozime,*

Komisioni, me votim unanimit, vendosi, që:

- 1. Lista me Propozimet e anëtarëve për Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturor të kthehet në Ministri për plotësim dhe ndryshim,*
- 2. Komisioni kërkon nga Ministria që në afatin sa me të shpejt ta procedoi listën e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor.*

4. Të ndryshme

Ismajl Kurteshi, propozoi që në mbledhjen e ardhshme të Komisionit, të futet në rend të ditës edhe afera për diplomat e falsifikuara në Pejë, ne si Komision duhet të interesohemi dhe të shohim se çka ka të vërtetë në atë dhe të japim mendimin tonë.

Teuta Haxhiu, tha se jemi vonuar për çështjen e diskutimit të diplomave dhe se është mirë që ka dal ky skandal në mënyrë që të mos punohet anëve jo ligjore. Ajo tha se në emër të Komisioni për Arsim ka kërkuar nga Agjencioni për Akreditim disa shkresa për një marrëveshje që është nënshkruar prej ish Ministrit të Arsimit dhe Ministrit të Drejtësisë për çështjen e një Universiteti në Graçanicë por nuk i'a kanë dërguar.

Shukrije Bytyqi, tha se propozon që në takim me Ministrin të diskutohet lidhur me gjendjen jo të mirë të arsimit në Luginën e Preshevës dhe të bëhet një marrëveshje rreth çështjes së literaturës dhe mundësisë që Ministria e Kosovës të bashkëpunojë me Ministrinë atje, sepse ligjet aktuale u'a lejojnë që të kenë literaturë prej shtetit amë.

Bekim Haxhiu, tha se sa i përket çështjes së diplomave në Universitetin e Pejës, Ministri i Arsimit e ka urdhëruar Inspektoratin e Arsimit ta bëjë një hetim të plotë dhe deri sa punojnë Institucionet e Hetuesisë ne si politikan mund të ngrisim shqetësim por nuk mund të interferojmë në procesin e hetimeve. Dhe tha se ne si Komision duhet të fokusohemi në përgatitjen e legjislacionit adekuat për ta ndihmuar zhvillimin e arsimit në Kosovë.

Shpejtim Bulliqi, tha se në takimin me Ministrin duhet të përcaktohem në një temë të diskutimit, e cila është aktuale apo më e rëndësishme.

Ismajl Kurteshi, tha se sa i përket çështjes së Preshevës, ne si Komision do të duhej ti kushtojmë rëndësi dhe të diskutojmë se për cilat çështje duhet Komisioni të bëjë një lloj lobimi te Ministria edhe te Qeveria për interesat e atyre njerëzve.

Kryetari i Komisionit, Nait Hasani, tha se po e ftojme Ministrin për të diskutuar për çështjen e diplomave dhe për gjendjen në arsimin e lartë. Ai po ashtu theksoi se kanë një ftesë për vizitë në Plavë, Podgoricë, Tuzë dhe në Ulqin për tu njohur me problemet e arsimit atje.

Ismajl Kurteshi, tha se për vizitën në Ulqin është mirë që paraprakisht të kontaktohet me komunën e Ulqinit dhe Drejtorinë e Arsimit sepse është lokaliteti ku ka shumë shqiptarë dhe të bëhet një lloj koordinimi.

Kryetari i Komisionit, Nait Hasani, tha se do të ftojme edhe Komisionin e Arsimit të Serbisë, për të diskutuar për gjendjen e arsimit në Kosovë dhe gjendjen e Arsimit në Luginë dhe për shqiptarët që janë atje.

Shpejtim Bulliqi, tha se ti drejtoheni me një shkresë zyrtare dhe nëse pranojnë të vijnë janë të mirëseardhur.

Ismajl Kurteshi, tha se Komisioni mund të bisedojë me Komisionin për Arsim të Republikës së Serbisë vetëm mbi parimin e reciprocitetit.

Kryetari i Komisionit, Nait Hasani, tha së bazuar në shqetësimet e ngritura lidhur me skandalet e fundit me diplomat e lëshuara, për mbledhjen e radhës të ftohet z.Arsim Bajrami, ministër i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë, për të raportuar për gjendjen në Arsimin e Lartë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani